



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 1871 Prot.

Tiranë më 29/12/ 2011

Lënda: Dërgim shkresës Nr. 6007, Datë /22/12/2011.

Drejtuar: Drejtorive Rajonale të AKU-së


Tiranë
Durrës
Vlorë
Fier
Elbasan
Berat
Gjirokastrë.
Korçë
Lezhë
Shkodër
Kukës
Dibër

Bashkangjitur po ju dërgojmë Urdhërin Nr.357, datë.22.12.2011 Për miratimin e rregullore “Mbi kushtet e tregimit dhe të përdorimit në disa kafshë të disa lëndëve me veprim hormonal ose tireostatik dhe të beta - agonistëve”

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



2-uj Dilme
te shpallur
Drejtoria e Shendetit
Pozitive
merrte 28.12.11
Blaz



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. 6007 Prot.

Tiranë, më 22/12/2011

Ant. Struga

URDHËR

Nr. 307 Datë 22.12 2011

26/12/2011

PER MIRATIMIN E RREGULLORES

“MBI KUSHTET E TREGTIMIT DHE TE PËRDORIMIT NË KAFSHË TË DISA
LËNDËVE ME VEPRIM HORMONAL OSE TIREOSTATIK
DHE TË BETA-AGONISTËVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 82, pika 3, te ligjit nr. 10465 date 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ

1. Miratimin e Rregullores “Mbi kushtet e tregtimit dhe te përdorimit në kafshë të disa lëndëve me veprim hormonal ose tireostatik dhe të beta-agonistëve”.
2. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
3. Urdhëri i Ministrit Nr. 311, datë 26.06.2006 “Mbi ndalimin e përdorimit, magazinimit dhe tregtimit të disa substancave me veprim hormonal apo tirostatik dhe beta-agonistëve”, shfuqizohet.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi më datë 01.01.2012.



RREGULLORE

“MBI KUSHTET E TREGTIMIT DHE TË PËRDORIMIT NË KAFSHË TË DISA LËNDËVE ME VEPRIM HORMONAL OSE TIREOSTATIK DHE TË BETA-AGONISTËVE”

Neni 1

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kushtet e tregtimit, të ndalimit ose përdorimit në kafshë, veçanërisht në kafshët prodhuese të ushqimeve, të disa lëndëve që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe të beta-agonistëve, pasi përdorimi i papërshtatshëm i tyre në këto kafshë dhe mbetjet e këtyre lëndëve në ushqimet me origjinë shtazore me prejardhje nga kafshët e trajtuara, mund të paraqesë një rrezik për shëndetin publik si dhe të ndikojnë negativisht mbi cilësinë e ushqimeve me origjinë shtazore.
2. Kjo rregullore përcakton lëndët me veprim hormonal ose tireostatik dhe të beta-agonistëve, të cilat ndalohen të përdoren në kafshë, ndalohen të mbahen në fermat blegtorale si dhe ndalohen të tregtohen.
3. Në këtë rregullore përcaktohen rastet kur autorizohet përdorimi i lëndëve me veprim hormonal dhe tireostatik në kafshët prodhuese të ushqimeve dhe gjithashtu përcaktohen rastet kur mund të autorizohet përdorimi i produkteve mjekësore veterinarë (PMV), të cilat kanë si lëndë aktive një lëndë beta-agoniste, për qëllime mjekësore të përcaktuara qartë dhe për disa kategori të kafshëve të llojit të gjedhit, njëthundrakëve dhe kafshëve të shoqërimit.

Neni 2

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e përcaktuara në nenin 4, të Ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”.
2. Përveç këtyre zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:
 - a) “kafshë ferme” janë kafshët shtëpiake të llojit të gjedhit, derrit, dhenve, dhive, njëthundrakët shtëpiake, shpendët dhe lepujt, si edhe kafshët e egra të këtyre llojeve dhe ruminantët e egër që mbahen në një fermë;
 - b) “trajtim mjekësor” quhet përdorimi pas kontrollit të kryer nga një mjek veterinar, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, në një kafshë ferme i një lëndë të autorizuar për të trajtuar një problem të riprodhimit, përfshi dhe ndërprerjen e barrsmërisë së padëshiruar, si dhe përdorimi i beta-agonistëve për të nxitur tokolizën në lopë gjatë pjelljes ose për të trajtuar probleme respiratore, sëmundjet e thundrave dhe çalimet dhe për të nxitur tokolizën tek njëthundrakët;
 - c) “trajtim për qëllime zooteknike” është përdorimi:

(i) tek një kafshë ferme i çdo lëndë të autorizuar sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje për sinkronizimin e afshit dhe përgatitjen e kafshëve dhuruese dhe pritëse për implantimin e embrioneve, pas ekzaminimit të kafshës nga një mjek veterinar ose nën përgjegjësinë e tij, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 6;

(ii) në rastin e kafshëve të akuakulturës, tek një grup kafshësh riprodhuese për ndërrimin e seksit, mbështetur tek një recetë veterinare dhe nën përgjegjësinë e mjekut veterinar;

d) “trajtim i paligjshëm” quhet përdorimi i lëndëve ose produkteve të paautorizuara ose përdorimi i lëndëve të autorizuara sipas legjislacionit veterinar në fuqi për qëllime ose kushte të tjera të ndryshme nga ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Lëndët e renditura në Aneksin I ndalohet të vendosen në treg për përdorim tek kafshët prodhuese të ushqimeve, për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 5, pika 2.

Neni 4

1. Tek kafshët e fermës ose të akuakulturës, ndalohet përdorimi me çdo lloj mënyre i lëndëve të renditura në Aneksin I dhe II.

2. Ndalohet mbajtja në fermë e kafshëve të përcaktuara në pikën 1 me përjashtim të rasteve të vendosura nën kontroll zyrtar, si dhe vendosja në treg ose therja për konsum nga njerëzit e kafshëve të fermës, që përmbajnë lëndë të përcaktuara në Aneksin I dhe II, ose kur është përcaktuar prania e lëndëve të tilla, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet se kafshët në fjalë janë trajtuar në përputhje me nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

3. Ndalohet vendosja në treg për konsum nga njerëzit e kafshëve të akuakulturës ku janë përdorur lëndët e sipërpërmendura si dhe përpunimi i produkteve me prejardhje nga kafshë të tilla.

4. Ndalohet vendosja në treg e mishit me prejardhje nga kafshët e përcaktuara në pikën 2 si dhe përpunimi i mishit të këtyre kafshëve.

Neni 5

1. Pavarësisht nga nenet 3 dhe 4, autoriteti kompetent veterinar autorizon:

(a) Përdorimin në kafshët e fermës, për qëllime mjekimi, të testosteronit dhe progesteronit dhe derivative që japin përbërjen fillestare me hidrolizën pas përthithjes në vendin e përdorimit. PMV e përdorur për trajtimin mjekësor duhet të plotësojë kërkesat për vendosjen në treg të përcaktuara në legjislacionin veterinar në fuqi. PMV-ja përdoret vetëm nga një mjek

veterinar, përmes injektimit ose për trajtimin e mosfunksionimit të vezoreve në formën e spiraleve vaginale, por jo përmes implantimit, tek kafshët e fermës të cilat janë të identifikuar qartë përmes numrit individual. Trajtimi i këtyre kafshëve të identifikuar duhet të shënohet në regjistrin e fermës nga mjeku veterinar që i shërben fermës. Mjeku veterinar duhet të shënojë në regjistrin e fermës të dhënat e mëposhtme:

- llojin e trajtimit;
- llojin e produktit të autorizuar për përdorim (PMV);
- datën e trajtimit;
- numrin e matrikullimit të kafshëve të trajtuara.

Regjistri i fermës i vihet në dispozicion Veterinerit Zyrtar të shërbimit veterinar rajonal me kërkesën e tij.

(b) Përdorimin për qëllime mjekimi të PMV të cilat përmbajnë:

- (i) alil trenbolone, që jepen nga goja, ose i beta-agonistëve tek njëhundurakët, me kusht që të përdoren në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;
- (ii) beta-agonistët, në formën e një injeksioni që nxit tokolizën tek lopët gjatë pjelljes.

2. Lëndët e përcaktuara në pikën 1 duhet të përdoren nga një mjek veterinar, ose në rastin e PMV të përmendur në nenparagrafin (i), mund të përdoren nga një teknik veterinar nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mjekut veterinar. Trajtimi duhet të shënohet në regjistrin e fermës nga mjeku veterinar përgjegjës, ku shënohen të paktën të dhënat e përmendura në paragrafin (a) më lart.

3. Fermerët ndalohen të mbajnë PMV të cilat përmbajnë beta-agonistë që mund të përdoren për të nxitur tokolizën.

4. Megjithatë, pa cënuar nenparagrafin (ii), ndalohet trajtimi mjekësor i kafshëve prodhuese të ushqimeve, përfshi edhe kafshët për riprodhim në fund të ciklit riprodhues të tyre.

Neni 6

1. Pavarësisht nga neni 3 dhe neni 4, pika 1, autoriteti kompetent veterinar mund të autorizojë përdorimin tek kafshët e fermës, për qëllime të trajtimit zooteknik, të PMV-ve që kanë një veprim estrogenik (të ndryshme nga 17β -estradioli dhe derivatet e tij të esterit), androgjenik ose gestagenik të cilat janë autorizuar në përputhje me legjislacionin veterinar në fuqi për PMV-të. Këto PMV mund të përdoren nga një mjek veterinar vetëm tek kafshët që janë qartësisht të identifikuar. Trajtimi duhet të shënohet në regjistrin e fermës nga mjeku veterinar përgjegjës në përputhje me nenin 5.

2. Autoriteti kompetent veterinar, mund të lejojë që sinkronizimi i afshit dhe përgatitja e kafshëve dhuruese dhe atyre marrëse për implantimin e embrioneve të kryhet edhe nga tekniku veterinar ose tekniku i ndërzimit, nën përgjegjësinë e mjekut veterinar.
3. Rasati i kafshëve të akuakulturës mund të trajtohet për 3 muajt e parë, me qëllimin e ndërrimit të seksit, me PMV të cilat kanë një veprim androgjen dhe që janë autorizuar në përputhje me legjislacionin veterinar në fuqi për PMV-të.
4. Në rastet e parashikuara në këtë nen, mjeku veterinar do të lëshojë një recetë ku përcaktohet qartë trajtimi në fjalë dhe sasia e PMV që nevojitet, si dhe shënon emrin e produktit që ka porositur.
5. Ndalohet trajtimi zooteknik i kafshëve prodhuese të ushqimeve, si dhe i kafshëve riprodhuese në fund të ciklit riprodhues të tyre gjatë periudhës së majmërisë.

Neni 7

1. Produktet hormonale dhe beta-agonistët, përdorimi i të cilave në kafshët prodhuese të ushqimeve autorizohet në përputhje me nenet 4 dhe 5, duhet të plotësojnë kërkesat e legjislacionin veterinar në fuqi për PMV-të.
2. Nuk mund të autorizohen sipas pikes 1:
 - (a) produktet hormonale të mëposhtme:
 - (i) produktet që veprojnë përmes një efekti depozitues;
 - (ii) produktet me një kohë pezullimi mbi 15 ditë pas përfundimit të trajtimit; si dhe
 - (iii) produktet:
 - të cilat nuk janë autorizuar sipas legjislacionin veterinar në fuqi për PMV-të;
 - të cilave nuk u njihen kushtet e përdorimit;
 - për të cilat mungojnë reagentë ose pajisje që mund të përdoren në teknikat analitike për zbulimin e pranisë së mbetjeve mbi kufijtë e lejuar.
 - (b) PMV që përmbajnë beta-agonistë që kanë një kohë pezullimi mbi 28 ditë pas përfundimit të trajtimit.

Neni 8

1. Për qëllime tregtimi, autoriteti kompetent veterinar mund të autorizojë vendosjen në treg të kafshëve për mbarështim ose të kafshëve riprodhuese në fund të ciklit të tyre riprodhues, të cilat gjatë kësaj periudhe të fundit i janë nënshtruar trajtimit të përmendur në nenet 5 dhe 6.
2. Mishi i kafshëve të përmendura në pikën 1 më lart, duhet të mbajë vulën veterinare dhe konsumi i tij për njerëz lejohet nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenet 5 dhe 6 si dhe nëse zbatohet koha e pezullimit e përcaktuar në autorizimin për tregtimin e PMV.

3. Tregtimi i kuajve me vlera të larta racore (i kuajve të garave, cirqeve ose i kuajve që përdoren për qëllime studimore ose për ekspozita), përfshi dhe njëhundrakët e regjistruar tek të cilët për qëllimet e përcaktuara në nenin 5 është përdorur alil trenboloni ose beta-agonistët përpara përfundimit të kohës së pezullimit, lejohet me kusht që të plotësohen kriteret për përdorimin e këtyre PMV dhe në çertifikatën veterinare ose pasaportën që shoqëron këto kafshë shënohet lloji dhe data e trajtimit.

2. Mishi ose produktet me prejardhje nga kafshët ku lëndët që kanë një veprim estrogen, androgen ose gestagen janë përdorur në përputhje me dispozitat përjashtimore të kësaj rregulloreje, mund të vendosen në treg për konsum nga njerëzit, në rast se kafshët në fjalë janë trajtuar me PMV që plotësojnë kërkesat e nenit 7 dhe përpara therjes së kafshëve të jetë respektuar koha e pezullimit e përcaktuar.

Neni 9

1. Kanë të drejtë të zotërojnë lëndët e përmendura në nenet 3 dhe 4 më lart për qëllime importi, prodhimi, magazinimi, shpërndarje, shitje dhe përdorimi të tyre, vetëm personat e përcaktuar nga legjislacioni veterinar mbi PMV-të.

2. Përveç kontrolleve të përcaktuara në legjislacionin veterinar në fuqi mbi PMV-të, shërbimi veterinar kryen kontrollet zyrtare në përputhje me nenin 11 të Rregullores Nr. 1, datë 17.03.2000, “Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore”, pa njoftim paraprak me qëllim që të verifikohet:

(a) zotërimi ose prania e lëndëve ose produkteve të ndaluara sipas neneve 3 dhe 4, që synohet të përdoren në kafshë me qëllim rritjen e peshës trupore gjatë majmërisë;

(b) trajtimin e paligjshëm të kafshëve;

(c) mos respektimin e kohës së pezullimit për rastet e përdorimit të tyre sipas përcaktimeve të nenit 7;

(d) mos respektimin e kufizimeve mbi përdorimin e disa lëndëve ose produkteve të përcaktuara në nenet 5 dhe 6;

3. Në përputhje me Anekset III dhe IV të Rregullores Nr. 1, datë 17.03.2000, “Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore” shërbimi veterinar merr kampionet nga kafshët e gjalla dhe nga produktet e tyre dhe i dërgon në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë ku kryhen testet e mëposhtme:

(a) për praninë e lëndëve të përcaktuara në pikën 1 më lart, tek kafshët, në ujin e pijshëm të kafshëve dhe në të gjitha vendet ku mbahen ose mbarështohen kafshët;

(b) për praninë e mbetjeve të lëndëve të përcaktuara në pikën 1 më lart, në kafshët e gjalla, jashtëqitjet e tyre, lëngjet e trupit, indet dhe produktet shtazore.

4. Në rastet kur nga kontrollet e kryera për pikat 2 dhe 3 më lart zbulohet prania e lëndëve ose produkteve që përmbajnë këto lëndë, përdorimi ose zotërimi i të cilave është i ndaluar, ose prania e mbetjeve të lëndëve, të cilat rezultojnë nga një trajtim i paligjshëm i kryer tek kafshët, këto lëndë ose produkte konfiskohen, ndërsa çdo kafshë e trajtuar ose mishi i tyre vendoset nën mbikqyrje zyrtare derisa të jenë zbatuar masat e kërkuara.

5. Në rastin e shkeljes së kërkesave të pikave 2(b) dhe 2(c), shërbimi veterinar merr masat e përshtatshme në përputhje me shkallën e shkeljes sipas legjislacionit veterinar në fuqi, si dhe njofton menjëherë strukturat e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Neni 10

1. Pa rënë ndesh me legjislacionin veterinar në fuqi për PMV-të, subjektet të cilat blejnë ose prodhojnë lëndë që kanë një veprim tireostatik, estrogenik, androgjenik ose gestagenik dhe beta-agonistët, subjektet e çdo lloji dhe madhësie të cilat janë autorizuar të tregtojnë këto lëndë, si dhe subjektet të cilat blejnë ose prodhojnë produkte farmaceutike ose PMV që përmbajnë lëndë të tilla, janë të detyruar të mbajnë regjistra të hollësishëm, ku shënohen në rend kronologjik sasi të prodhuara ose të blera dhe ato të shitura ose të përdorura për prodhimin e produkteve farmaceutike dhe të PMV, bashkë me emrat e personave të cilëve ju shitën ose blenë sasi të tilla të produkteve.

2. Informacioni i mësipërm duhet të paraqitet autoritetit kompetent veterinar ose shërbimit veterinar rajonal, me kërkesën e tyre. Në rastin kur këto informacione ruhen në formë elektronike ato paraqiten në formën e shtypur.

Neni 11

1. Ndalohet importi i kafshëve të fermës ose të akuakulturës si dhe i mishit ose produkteve me prejardhje nga këto kafshë, prej atyre vendeve legjislacioni i të cilave lejon vendosjen në treg dhe përdorimin e stillbeneve, derivateve, kriprave dhe estereve të stillbeneve, ose të lëndëve tireostatike për përdorim në të gjitha llojet e kafshëve, mishi dhe produktet e të cilave do të përdoren për konsum nga njerëzit.

2. Gjithashtu, ndalohet importi nga vendet e tjera:

(a) i kafshëve të fermës ose të akuakulturës tek të cilat:

(i) janë përdorur me çdo rrugë produktet ose lëndët e përcaktuara në Aneksin I, Lista A;

(ii) janë përdorur lëndët e përcaktuara në Aneksin I, Lista B dhe në Aneksin II, me përjashtim të rastit kur këto lëndë janë përdorur në përputhje me dispozitat dhe

kërkesat e përcaktuara në nenet 5, 6 dhe 8 dhe janë respektuar kohët e pezullimit të lejuara në legjislacionin veterinar;

(b) i mishit ose i produkteve shtazore me prejardhje prej kafshëve, importi i të cilave është i ndaluar sipas pikes (a).

3. Kafshët që mbahen për mbarështim si dhe kafshët riprodhuese në fund të ciklit të tyre riprodhues, ose mishi i tyre, të cilat vijnë nga vendet e tjera, mund të importohen nëse paraqesin garanci të paktën të barazvlefshme me ato të përcaktuara në përputhje me procedurën e nenit 33 të Rregullores Nr. 1, datë 17.03.2000, “Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore” (e cila përfron Direktivën e Bashkimit European 96/23/EC), për qëllimin e zbatimit të kreut V të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Në lidhje me lëndët e listuara në Aneksin II, autoriteti kompetent veterinar siguron që përmbajta e këtij Aneksi të jetë në mënyrë të vazhdueshme e përditësuar me ndryshimet e legjislacionit të Bashkimit European mbi këtë kategori lëndësh.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 01 janar 2012.

ANEKSI I

Lista e lëndëve të ndaluara:

Lista A: lëndët e ndaluara

- Lëndët tirostatike,
- Stilbenet, derivatet e stilbeneve, kriprat dhe esteret e tyre,
- Estradiol 17 β dhe derivatet e tij të ngjashme me esteret.

Lista B: lëndët e ndaluara me përjashtime

- Beta-agonistët

ANEKSI II

Lista e lëndëve të ndaluara përkohësisht:

Lëndë që kanë veprim estrogenik (të ndryshme nga 17β -estradioli dhe derivatet e tij të ngjashme me esteret), androgjenik ose gestagenik.